

VENDIM
Nr. 172, datë 18.5.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË ALPEX SHA
LIDHUR ME KOMITETIN E BURSËS SHQIPTARE TË ENERGJISË**

Në mbështetje të neneve 16, 18, pika 1, germa “a” dhe “dh”; nenit 19 germa “a”, neneve 57 dhe 98 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikave B. 2.2 , B. 3.3.1 dhe B.3.3.2 të “Rregullave të tregut të energjisë elektrike, kushtet e përgjithshme”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022; si dhe neneve 19 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës, me nr. 1300/1 prot., datë 17.5.2023, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kërkesës së ALPEX sh.a. lidhur me Komitetin e Bursës Shqiptare të Energjisë”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, vendosi të miratojë “Rregullat e tregut të energjisë elektrike” (kushtet e përgjithshme, përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e klerimit dhe të shlyerjes).

- Shoqëria ALPEX sh.a., me shkresën nr. 128 prot., datë 19.4.2023, protokolluar me tonën me nr. 1300 prot., datë 24.4.2023, ka paraqitur për miratim procedurën e Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë.

- Në pikat B.2.2, B.3.3.1 dhe B.3.3.2, germa “a” të “Aspekteve ligjore dhe të qeverisjes, të kushteve të përgjithshme të ‘Rregullave të tregut të energjisë elektrike’”, përcaktohen ndër të tjera roli i Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë, si dhe përgjegjësia e ALPEX sh.a. për hartimin, përditësimin dhe paraqitjen për miratim pranë autoriteteve rregullatore të procedurës së Komitetit të Bursës.

- Procedura e paraqitur për miratim nga shoqëria ALPEX sh.a. përbëhet nga tetë kapituj, shtojca A me anëtarët e Komitetit fillestar të Bursës si dhe aplikimi për anëtarësim dhe pjesëmarrje në këtë Komitet.

- Ngritja e Komitetit të Bursës, si një organ konsultativ i zgjedhur nga anëtarët e Bursës është i nevojshëm për promovimin e “Rregullave të tregut të energjisë elektrike”, që ato të mbeten aktuale dhe të përditësuara me kalimin e kohës, nëpërmjet konsultimit dhe këshillimit me ALPEX-in për ndryshimin e “Rregullave të tregut të energjisë elektrike”.

- Në pikën B.2.3.1 të rregullave, “Përbërja e Komitetit të Bursës”, përcaktohet se komiteti duhet të pasqyrojë llojshmërinë e anëtarëve të Bursës, sipas tipit të licencave që anëtarët e Bursës zotërojnë. Ndërsa në pikën B.2.3.2 përcaktohet se Komiteti i Bursës do të përbëhet nga jo më shumë se 10 (dhjetë) anëtarë, ku 8 (tetë) anëtarë janë të zgjedhur nga anëtarët e Bursës dhe dy anëtarë janë të emëruar nga ALPEX-i, ku njëri prej të cilëve do të jetë kryetari i Komitetit.

- Sikurse evidentuar dhe më sipër ky komitet ka një rol konsultativ për ALPEX sh.a. dhe në fazën fillestare të operimit të ALPEX që prej datës 11.4.2023, roli konsultativ i komunitetit mund të ketë ndikim pozitiv në operimin e bursës dhe në bërjen e propozimeve nëse është e nevojshme për përmirësimin e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e kërkesës së shoqërisë ALPEX sh.a. lidhur me procedurat e Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi